



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_356_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_559_03_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_559_03_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Sadri Velu, Separacioni "Agimi" (parashtruesi i ankesës Hamëz Velu), shifra e konsumatorit DPZ – 9023860, nga Fshati Krusha e Madhe, Prizren, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 01.06.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 31.05.2010 lidhur me kontestimin e faturës 06/2007.

- Me datë 13.07.2007 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike me 494.88 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 1328.33 €. **Provë:** Fatura e muajit 06/2007
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit 06/2007. **Provë:** Ankesa e konsumatorit
- Me datë 31.05.2010 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në korrigjimin e bërë me datë 18.05.2010. **Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 31.05.2010
- Me datë 01.06.2010, konsumatori ka apeluar përgjigjur e KEK-ut në DMK të ZRRE-së. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ KEK-u për llogaritjen e faturës së muajit qershor 2007 nuk ka marr për bazë gjendjen reale të kilovatëve të shpenzuar e të regjistruar në procesin e leximit nr. 003979, ku gjendja në



tarifën e lartë është 619.65 kWh, por KEK-u ka gabuar dhe ka faturuar konsumatorin me 965.71 kWh.

- ✓ Pas gabimit të bërë nga KEK-u në faturimin e energjisë elektrike të bërë konsumatorit për periudhën 06/2007, konsumatorit nuk i është bërë korigjimi i asaj fature të kontestuar, por KEK-u për të korigjuar gabimin e bërë gjatë faturimit gjatë periudhës 07/2007 deri më 07/2008, ka tentuar që të përmirësoj gjendjen në tarifën e lartë. Gjatë kësaj periudhe KEK-u konsumatorin në tarifën e lartë ka faturuar konsumatorin me vlerën zero deri sa edhe është barazuar gjendja në të cilën është bërë gabimi.

Provë: Faturat e energjisë elektrike dhe procesverbalet e leximit të grupit matës

- ✓ Bazuar në raportin e komisionit të KEK-ut krijuar për shqyrtimin e ankesës së konsumatorit vërehet se komisioni i KEK-ut ka vendosur që të bëhet korigjimi (rillogaritja) i të gjitha faturave nga periudha 06/2007 deri më 08/2008 bazuar në procesverbalet e leximit duke anuluar edhe faturën e kontestuar nga konsumatori. Gjatë rillogaritjes së faturave për periudhën e përmendur vërehet se vlera totale e faturave për periudhën 06/2007 deri më 08/2008 në CCP ka qenë 3,144.95 €, por që faturat e rillogaritura për periudhën e njëjtë bazuar në leximin real duhet të jetë 3,315.16 €, ndërsa diferenca e rillogaritur në vlerë financiare është 170 €.

- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se kundërshton faturën e muajit qershor 2007 ngase nuk ka bërë atë shpenzim të energjisë elektrike. Konsumatori deklaron se nuk ka pasur mundësi të ketë bërë shpenzim të tillë të energjisë. Në deklaratën e konsumatorit theksohet se pas pranimit të faturës 06/2007 ka kërkuar nga organet e KEK-ut që të bëhet korigjimi i së njëjtës pasi që ka dyshuar se faturimi nuk është bërë në bazë të shpenzimeve reale.

Provë: Ankesa e konsumatorit

- ✓ Bazuar në faturat e energjisë elektrike dhe proceseve të leximit, DMK konstaton se Departamenti i faturimit është dashur që me kohë të bëjë korigjimin e faturës 06/2007 dhe se në asnjë mënyrë të mos e faturoj konsumatorin për periudhën 07/2007 deri më 08/2008 duke marruar tarifën e lartë me vlerë zero.

Provë: Faturat e energjisë elektrike dhe procesverbalet e leximit të KEK-ut.

- ✓ Me datë 18.05.2010 Departamenti i faturimit në KEK bazuar në raportin e komisionit të përpiluar me datë 12.05.2010 ka korigjuar faturat për periudhën 06/2007 deri më 08/2008 në vlerën financiare 170 €.

Provë: Urdhër lejimi nr. 17299 datë 18.05.2010

- ✓ Bazuar në analizën procesverbaleve të leximit konstatohet se leximi i njehsorit elektrik është bërë çdo muaj ashtu siç parashihet me rregullat dhe procedurat në fuqi dhe se gjendja e lexuar përputhët me shpenzimet e konsumatorit.

Provë: Procesverbalet e leximit

- ✓ DMK ka shqyrtuar të gjitha procesverbalet e leximit si dhe ri llogaritjen e bërë nga KEK-u të faturave për periudhën 06/2007 deri më 08/2008 dhe konstaton se KEK-u ka gabuar në llogaritjen e parë të faturës për periudhën 06/2007, dhe se është dashur që menjëherë të bëjë rregullimin asaj fature, por që gjatë ri llogaritjes së faturave ka përmirësuar gabimin e bërë dhe se ajo rillogaritje është e bazuar në leximin e saktë të shpenzimeve të konsumatorit (procesverbalet e leximit të grupeve matëse).



DMK, duke marrë parasysh argumentet dhe analizat e bëra, në veçanti ri llogaritjen e faturave të energjisë elektrike për periudhën 06/2007 deri më 08/2008 bazuar në leximin e saktë, rekomandon bordin e ZRRE-së që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar